



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/ 07

Datë: 13.01.2022

PROCESVERBAL

i mbledhjes së parë (I) të jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Malishevës

R E N D I D I T Ë S

1. Formimi i komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit, konform Udhëzimit Administrativ nr.2009/01, për procedurën e zgjedhjes dhe përgjegjësitë e kryesuesit të Kuvendit të Komunës.
2. Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, konform nenit 41 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale në Republikën e Kosovës.

Mbledhja u mbajt me datë: 24.12.2021 dhe filloi në ora: 10:20. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: 24 asambleistë, kryetari z.Ekrem Kastrati, përfaqësues nga OSBE-ja, ish-kryesuesi Rrahim Morina, qytetarë nga komuna e Malishevës, media dhe zyra për informim. Mbledhjen e kryesoi antari më i vjetër i Kuvendit z.Hajdin Berisha.

Hajdin Berisha: Përshëndetje për të gjithë! Për shkak të kushteve teknike të cilat nuk janë të përshtatshme, sepse seanca duhet të moniterohet, unë propozoj që seanca e sotme të shtyhet. Kush është për, që kjo seancë të shtyhet për të Martën në ora 10:00?

Për: 24

Kundër: 0

Abstenim: 0

Me 24 vota për, seanca e sotme shtyhet për të Martën. Faleminderit për prezencën!



Vazhdimi i mbledhjes së parë (I) të jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Malishevës

Mbledhja u mbajt me datë: 28.12.2021 dhe filloi në ora: 10:20. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: 31 asambleistë, kryetari z. Ekrem Kastrati, ish-kryesuesi Rrahim Morina, përfaqësues nga OSBE-ja, qytetarë nga komuna e Malishevës media dhe zyra për informim. Mbledhjen e kryesoi antari më i vjetër i Kuvendit z.Hajdin Berisha.

Hajdin Berisha: I nderuar Kryetar i Komunës z.Ekrem Kastrati, të nderuar asambleistë dhe gjithë ju të pranishëm në sallë përshëndetje për të gjithë!

Po fillojmë me vazhdimin e mbledhjes së parë të jashtëzakonshme. Prezent në sallë janë 31 asambleistë. Fjalën e ka Eqrem Morina, i cili do të bëjë betimin si asambleistë i Kuvendit Komunal në Malishevë

Eqrem Morina: Përshëndetje për të gjithë! Unë Eqrem Morina betohem se do t'i kryej me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegjje, sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si këshilltarë i Kuvendit të Komunës së Malishevës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë. Faleminderit!

Hajdin Berisha: I nderuar Eqrem, mirëserdhe dhe zyrtarisht në asamblenë komunale, pas përfundimit të të gjitha procedurave të nevojshme. Nga KQZ –ja është bërë plotësimi dhe zëvendësimi i antarit nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

Pikat e rendit të ditës janë këto:

1.Formimi i komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit, konform Udhëzimit Administrativ nr.2009/01, për procedurën e zgjedhjes dhe përgjegjësitë e kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

2.Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, konform nenit 41 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale në Republikën e Kosovës.

E hedh në votim rendin e ditës, kush është për? Unanimisht votohet rendi i ditës.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës: Formimi i komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit, konform Udhëzimit Administrativ nr.2009/01, për procedurën e zgjedhjes dhe përgjegjësitë e kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Ky komision duhet t'i ketë 3 ose 5 antarë. Meqenëse janë më shumë se tre subjekte, e hedhi në votim për 5 antarë.

Kush është për?

Komisioni prej 5 antarëve votohet unanimisht.

Fillojmë me propozimet.Urdhëro, Avdi!

Avdi Morina: Nisma Social Demokrate për antarë të komisionit për mbarvajtjen e procesit për zgjedhjen e kryesuesit propozon Bashkim Krasniqin.

Hajdin Berisha: Urdhëro, Nebih!

Nebih Bibaj: Partia Demokratike e Kosovës propozon Alban Kastratin.

Hajdin Berisha: Urdhëro, Labinot!

Labinot Gashi: LDK-ja propozon Hamit Limaj.

Hajdin Berisha: Urdhëroni, Veton!

Veton Zogaj: Ne si grup i asambleistëve nga VV propozojmë Arbnore Hotin si antare të komisionit.

Hajdin Berisha: Urdhëro, Donjeta!

Donjeta Shijaku: Nga AAK propozojmë Eqrem Morinen.

Hajdin Berisha: Propozimet sipas subjekteve politike janë: Bashkim Krasniqi nga Nisma, Alban Kastrati nga PDK, Hamit Lima nga LDK-ja, Arbnore Hoti nga VV-ja, Eqrem Morina nga AAK-ja. Komisioni në këtë përbërje, shkon në votim.

Kush është për?

Për: 30

Kundër: 0

Abstenim: 1

Me 30 vota për, asnjë kundër dhe 1 abstenim, formohet komisionit prej 5 antarëve për mbarëvajtjen e procesit të votimit, për zgjedhjen e kryesuesit. Të gjithë antarëve të komisionit ju lus të marrin pozicionet e veta.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës: Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, konform nenit 41 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale në Republikën e Kosovës. Shkojmë me propozime për kandidatë për kryesues të kuvendit të komunës së Malishevës. Urdhëro, Nebih!

Nebih Bibaj: Ne Partia Demokratike e Kosovës nominojm për kryesuese të Kuvendit Komunal në Malishevë Mirlinda Gashin. Kërkoj voten dhe besimin prej të gjithë antarëve të kuvendit, që janë të zgjedhur në Kuvendin Komunal të Malishevës.

Hajdin Berisha: Urdhëro, Argjend!

Argjend Thaçi: Përshëndetje për të gjithë! I nderuar kryesues, i nderuar kryetar i Komunës së Malishevës. Unë jam Argjend Thaçi, vi nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe paraqes kandidaturën time për kryesues të Kuvendit Komunal të Malishevës. Unë kërkoj votën dhe mbështetjen nga të gjithë asambleistët.

Hajdin Berisha: I kemi dy propozime Mirlinda Gashi nga PDK-ja dhe Argjend Thaçi nga radhët e LDK-së. Sekretaria deri të përgadit fletëvotimet, kemi 5 min pauz.

Disa sqarime nëse dikush nuk ka pasur mundësi ta lexojë Udhëzimin Administrativ, votimi dhe zgjedhja e kryesuesit:

1. Votimi për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit të Komunës bëhet me vota të fshehta.
2. Për tu zgjedhur në votimin e parë kandidati i propozuar për kryesues të Kuvendit të Komunës duhet të marrë më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të antarëve të kuvendit të komunës.

3. Nëse pas votimit të parë asnjëri nga kandidatët e propozuar për kryesues të kuvendit të komunës, nuk merr më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të antarëve të Kuvendit të Komunës, atëherë dy kandidatët të cilët kanë fituar numrin më të madh të votave, shkojnë në votimin e dytë.

Kandidati i cili merr më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të antarëve të Kuvendit të Komunës, në rundine dytë zgjidhet kryesues i Kuvendit të Komunës.

Nëse dhe pas rundit të dytë, asnjëri nga kandidatët nuk ka fituar shumicën e kërkuar si në pikën tre të këtij udhëzimi, atëherë shkohët në votimin e tretë. Në votimin e tretë kryesuesi i Kuvendit të Komunës, zgjidhet kandidati i cili merr më shumë se gjysmën e votave të antarëve të pranishëm. Nëse dhe pas votimit të tretë nuk zgjidhet kryesuesi i Kuvendit të Komunës, atëherë i gjithë procesi për zgjedhjen e kryesuesit përsëritet.

Atëherë, fillojmë me procedurën e votimit. Unë i thërras me emër dhe tek komisioni merren fletëvotimet.

Blerim Thaçi

Rukije Bytyqi

Jahir Xhyliqi

Amrush Helshani

Bashkim Krasniqi

Urim Thaçi
Avdi Morina
Besartë Ramaj
Fjoralba Hoxha
Mirlinda Gashi
Burim Paqarizi
Valjete Hoti
Nebih Bibaj
Alban Kastrati
Bledar Kryeziu
Sadik Vrenezi
Arlindë Rudi
Labinot Gashi
Argjend Thaçi
Driton Kastrati
Hamit Lima
Zamire Morina
Adile Hoxha
Veton Zogaj
Valon Krasniqi
Arlind Morina
Agnesa Kastrati
Arbnore Hoti
Eqrem Morina
Donjeta Shijaku
Hajdin Berisha

Hajdin Berisha: Të gjithë asambleistët kanë marrur pjesë në votim. Komisioni për votim është përgjegjës që t'i numëroj votat dhe t'i komunikojë rezultatet e votimit para antarëve të Kuvendit të Komunës. Ju lutem komisioni të fillojë me numrin e votave.
Urdhëroni, fjalën e ka komisioni në dhënjen e rezultateve!

Alban Kastrati- Antarë i komisionit: Komisioni për verifikimin dhe numrimin e votave, ka numruar votat dhe rezultati është kështu:

Argjend Thaçi -14 vota

Mirëllinda Gashi- 14 vota dhe tre vota janë të pa vlefshme.

Hajdin Berisha: Faleminderit, komisioni! Në ruandin e parë të votimit nuk kemi zgjedhje të kryesuesit. Vazhdojmë me rundin e dytë. 5 min pauzë deri të përgaditen fletëvotimet.

Atëherë, fillojmë me rundin e dytë të votimit për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Malishevës. Në fletëvotim e keni vërejtje të rrumbullakoni numrin ose emrin e kandidatit për kryesues, përndryshe vota juaj është e pavlefshme.

Atëherë, fillojmë me procedurën e votimit.

Blerim Thaçi

Rukije Bytyqi

Jahir Xhyliqi

Amrush Helshani

Bashkim Krasniqi

Urim Thaçi

Avdi Morina

Besartë Ramaj

Fjoralba Hoxha

Mirlinda Gashi

Burim Paqarizi

Valjete Hoti

Nebih Bibaj

Alban Kastrati

Bledar Kryeziu

Sadik Vrenezi

Arlindë Rudi

Labinot Gashi

Argjend Thaçi

Driton Kastrati

Hamit Lima
Zamire Morina
Adile Hoxha
Veton Zogaj
Valon Krasniqi
Arlind Morina
Agnesa Kastrati
Arbnore Hoti
Eqrem Morina
Donjeta Shijaku
Hajdin Berisha

Përfundon rundi i dytë i votimit. Kërkoj nga komisioni që të bëjë hapjen e kutisë së votimit, numrin e votave dhe kumtimin e rezultateve.

Alban Kastrati- Antarë i komisionit: Komisioni konstaton se në kuti janë 31 fletëvotime, 28 fletëvotime janë të vlefshme dhe 3 janë të pavlefshme. Konstatojmë që Argjend Thaçi ka marrur 15 vota, ndërsa Mirëllinda Gashi ka marrur 13 vota.

Hajdin Berisha: Faleminderi, komisioni! Dhe në rundin e dytë nuk kemi zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit Komunal. Jemi të obliguar që të vazhdojmë me rundin e tretë të votimit. Derisa sekretaria të përgadit fletëvotimet, shkojmë në pauzë 5 min.

Prezent në sallë janë 15 asambleistë. Në mbledhje nuk janë prezent grupi nga PDK-ja, nga LDK-ja nuk morën pjesë: Labinot Gashi, Zamire Morina, Adile Hoxha Hamit Lima, nga VV-ja nuk morën pjesë: Veton Zogaj, Agnesa Kastrati, Arbnore Kastrati, nga Lista Guxo nuk mori pjesë Valon Krasniqi.

Për mungesë të korumit shkohet në pauzë prej 10 min.



Hajdin Berisha: Urdhëro Nebih!

Nebih Bibaj: Të nderuar antarë të kuvendit, unë kërkoj nga ju që të bëjmë një pauz deri në ora 15:00, dhe pas orës 15:00 të vazhdohet me seancën e Kuvendit.

Hajdin Berisha: Urdhëro, Avdi!

Avdi Morina: Unë mendoj që duhet të kemi një sqarim ligjor. Jemi në proces të votimit dhe në çoftëse dështon, duhet ta kemi të qartë që duhet të thirret një seancë e re dhe të fillohet prej pikës së parë të rendit të ditës.

Hajdin Berisha: Kush është për shtyerjen e seancës deri në ora 15:00?

Për: 16

Kundër: 15

Me 16 vota për, seanca shtyhet për sot në ora: 15:00.



Vazhdimi i seancës në ora: 15:00.

Prezent në sallë janë 16 asambleistë. Në mbledhje nuk morën pjesë grupi nga PDK-ja, nga LDK-ja nuk morën pjesë: Labinot Gashi, Zamire Morina, Adile Hoxha, nga VV-ja nuk morën pjesë Veton Zogaj, Agnesa Kastrati, Arbnore Kastrati, nga Lista Guxo nuk mori pjesë Valon Krasniqi.

Hajdin Berisha: Në fillim komisioni u votua që të jetë prej 5 antarëve, mirëpo me lagimin e dy subjekteve nga salla, komisioni mbetet me tre antarë.

Kush është për, që komisioni të mbetet me 3 antarë?

Për: 16

Me 16 vota për komisioni mbetet me tre antarë.

Prezent në sallë janë 16 asambleistë. Shkojmë në rundin e tretë të votimit.

Blerim Thaçi

Rukije Bytyqi
 Jahir Xhyliqi
 Amrush Helshani
 Bashkim Krasniqi
 Urim Thaçi
 Avdi Morina
 Besartë Ramaj
 Fjoralba Hoxha
 Mirlinda Gashi Mungon
 Burim Paqariz Mungon
 Valjete Hoti Mungon
 Nebih Bibaj Mungon
 Alban Kastrati Mungon
 Bledar Kryeziu Mungon
 Sadik Vrenezi Mungon
 Arlindë Rudi Mungon
 Labinot Gashi Mungon
 Argjend Thaçi
 Driton Kastrati
 Hamit Lima
 Zamire Morina Mungon
 Adile Hoxha Mungon
 Veton Zogaj Mungon
 Valon Krasniqi Mungon
 Arlind Morina
 Agnesa Kastrati Mungon
 Arbnore Hoti Mungon
 Eqrem Morina
 Donjeta Shijaku
 Hajdin Berisha

Kërkoj nga komisioni që të bëjë hapjen e kutisë së votimit, numrin e votave dhe kumtimin e rezultateve.

Bashkim Krasniqi- Antarë i komisionit: Në kutin e votimit kanë qenë 16 vota, prej të cilave 15 vota janë të vlefshme dhe një është e pavlefshme. Kandidati për kryesues Argjend Thaçi ka marrur 15 vota.

Hajdin Bersha: Ju lutem komisionit, që i gjithë materiali të dërzohet te sekretaria e Kuvendit. Falenderoj të gjithë asambleistët për kontributin e dhënë përgjatë këtyre tre seancave për zgjedhjen e kryesuesit!

Të gjithë qytetarëve të Komunës së Malidhevës ju uroj zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Malishevës!

Me 15 vota për dhe një votë e pavlefshme, Kryesues i Kuvendit Komunal në Malishevë zgjedhet Argjend Thaçi. Argjend, fillimisht dëshirojë të kesh shëndet, punë të mbarë dhe bashkëpunim!, Llogarit në përkrahjen tonë nga të gjithë ne që jemi këtu në asamblenë komunale dhe sigurisht interesi më i madh është interesi i qytetarëve të Malishevës, për një bashkërrugëtim të suksesshëm. Të ftoj për një fjalë rasti!

Argjend Thaçi: Përsëritet! I nderuar Kryetar i Komunës së Malishevës z.Ekrem Kastrati, kryesuesi i kësaj seance z. Hajdin Berisha, këshilltarë të kësaj legjislature të re, të nderuara familje të Dëshmorëve, Invalidëve dhe Veteranëve të Luftës së UÇK-së së Kosovës!

Të nderuar ju të pranishëm këtu në sallë, ju faleminderit që më dhatë përgjegjësin që sot me votë të fshehtë dhe demokratike të jem kryesues i Kuvendit komunal të Malishevës!

Përgjegjësia ime si kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevës me votë të fshehtë dhe unanime, më bënë të bëhem më përgjegjës para qytetarëve të komunës tonë, para ligjit dhe pozitës sime. Zotohem se do t'i zbatoj plotësisht dhe paanshmërisht për të gjithë.

Do të jem bashkëpunues, komunikues dhe veprues i zgjidhjeve brenda kornizave ligjore, statusit të komunës, rregullores së kuvendit, komiteteve obligative si komitetit për Politikë dhe Financa dhe komitetit për Komunitete dhe komiteteve jo obligative dhe të krijoj mundësi për të gjithë sektorët institucional, që zbatojnë planet për programet për qytetarët e Komunës së Malishevës.

Do të jem në pajtueshmëri me udhëzimet, ligjet e qeverisjes lokale. Nuk do të ketë anshmëri.

Në planin e kuvendit do të kemi efikasitet dhe zbatueshmëri në temat që prekin nevojat e qytetarëve tanë, në gjithë sektorët si socialo-ekonomik, shëndetësor, infrastrukturorë, që me këtë

të tregojmë gadishmërinë e bashkëpunimit të fortë ,qeveri lokale dhe kuvend, në hartimin e projekt buxhetit, pra, buxhet për qytetarët.

Me udhëheqjen time me kuvendin, këshilltarët komunal, komitetet, kryetari i komunës, si kryesues mbaj bindjet për një Malishevë të zhvilluar, dhe shembull për bashkëpunim ndërinstitutional, vetëm e vetëm në përmbushjen e programit qeverisës dhe premtimet që i kemi dhënë para qytetarëve tanë. Ju faleminderit shumë për besimin!


Të nderuar asamblesitë! Me rastin e zgjedhjes së kryesuesit të Kuvendit Komunal, seancën e sotme e shpallim të mbyllur. Faleminderit për prezencën tuaj!

Mbledhja përfundoi në ora:15:45.

+

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina



Antari më i vjetër i Kuvendit

